

Titulli i lëndës: Realizmi deri te Simbolizmi

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Realizmi deri te Simbolizmi
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i III, semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Naser Mrasori
Të dhënat kontaktuese:	Naser.Mrasori@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi i lëndës “Letërsi Gjermane prej Realizmit deri te Simbolizmi” në nivelin BA, synon të ofrojë qasje në historinë dhe temat e letërsisë gjermane të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, e paraparë për studentët e këtij niveli. Në këtë kurs studentët do të njihen me rrjedhën historike dhe letrare, temat letrare dhe karakteristikat e letërsisë, me krijimtarinë dhe jetën letrare, gjinitë letrare si dhe me përfaqësuesit kryesorë të periudhave të Realizmit, Naturalizmit, Impresionizmit, Simbolizmit, Modernes Vjeneze, me ç’rast është paraparë edhe leximi dhe analiza e disa veprave të autorëve nga kjo periudhë, si p.sh.: Keller, Storm, Fontanne, Holz, Hauptmann, Lilienkron, Schnizler, Mann, Hesse, Stifter, Meyer, Hebbel, Rabbe, Busch, Nitsche, Freud, Rilke, Huch, Morgenstern, Hofmansthal etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i këtij kursi synon që studentëve t'u ofroj njohuri të mjaftueshme:

- për konceptet themelore të letërsisë të këtyre periudhave;
- për rrjedhën historike dhe ngjarje me të rëndësishme;
- për temat dhe gjinit kryesore të letërsisë të kësaj periudhe;

për krijimtarinë letrare të përfaqësuesve të kësaj periudhe letrare

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Nga studentët pritet të njohin rrjedhën historike dhe letrare, temat dhe karakteristikat kryesore, si dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe të letërsisë gjermane . Studentët do të njihen me veprat dhe autorët më të njohur të kësaj periudhe, me qëllim për të kuptuar mënyrën dhe objektin e krijimtarisë letrare të këtyre periudhave. Ata do të marrin njohuri për: për rrjedhën historike dhe për ngjarjet me të rëndësishme të këtyre periudhave; për temat dhe gjinit kryesore të letërsisë së kësaj periudhe; për krijimtarinë letrare të përfaqësuesve të këtyre periudhave letrare

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30

Konsultime me mësimdhënësin	10min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	15	30
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	8	3	24
Përgatitja për provimin final	2	1	2
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			153:25= 6.12 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorur materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentësh në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi është paraparë të bëhet sipas statutit dhe rregulloreve të Universitetit të Prishtinës, provimi organizohet me shkrim dhe me gojë. Duke pasur parasysh edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si p.sh. pjesëmarrja në ligjerata, angazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet, etj. Rezultati përfundimtar llogaritet si në vijim: - Pjesëmarrja aktive, përfundimi i seminareve dhe detyrave në kohë dhe angazhimi në - Pjesëmarrja, detyrat dhe angazhimi (20%) - Testi i parë (30 %) - Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) (50%)
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fritz Martini: Deutsche Literaturgeschichte. Von den Anfängen bis zur Gegenwart. 19., neu bearbeitete Auflage. Kröner, Stuttgart 1991. 2. Heinz Forster & Paul Rieger: Deutsche Literaturgeschichte. Band 7 & München 2002. 3. Joachim Bark, Dietrich Steinbach, Hildegard Wittenberg Hrsg: Epochen der deutschen Literatur (Gesamtasugabe) Klett, Stuttgart 1989. 4. Gerald Reiner, Norbert Kern, Eva Rainer: Geschichte der deutschsprachigen Literatur. Veritas Verlag Linz. 4 Auflage 2004. 5. Edward McInnes, Gerhard Plumpe (Hrsg.): Bürgerlicher Realismus und Gründerzeit. München 1996 6. Hugo Aust: <i>Realismus. Lehrbuch Germanistik</i>. Stuttgart, 2006. 7. Richard Brinkmann (Hrsg.): Begriffsbestimmung des literarischen Realismus. Darmstadt, 1987.

	<ol style="list-style-type: none"> 8. Sabina Becker: Bürgerlicher Realismus. Literatur und Kultur im bürgerlichen Zeitalter. Tübingen, Basel, 2003. 9. Deutsche Literaturgeschichte 10. Wolfgang Beutin, Klaus Ehlert, Wolfgang Emmerich, Helmut Hoffacker, Bernd Lutz, Volker Meid, Ralf Schnell, Peter Stein, Inge Stephan. Springer-Verlag Berlin Heidelberg 1992.
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Stephan Kohl: Realismus: Theorie und Geschichte. München 1977. 2. Reinhard Lauer (Hrsg.): <i>Europäischer Realismus</i>. Wiesbaden 1980. 3. Klaus-Detlef Müller (Hrsg.): <i>Bürgerlicher Realismus</i>. Grundlagen und Interpretation, 1981.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java e pare	Realizmi; realizmi poetik, kritik dhe shoqëror
Java e dytë	Realizmi si program; programi i realizmit poetik
Java e tretë	Romani dhe novela në perudhën e realizmit
Java e katërt	Formimi dhe romani formues (Bildung & Bildungsroman)
Java e pestë	Lirika në epokën e Realizmit
Java e gjashtë	Romani shoqëror, tregimi historik, historitë nga fshati, problemet sociale
Java e shtatë	Letërsia popullore, fuqia e konvencioneve shoqërore në letërsinë e realizmit
Java e tetë	Drama e realizmit – drama që trajton jetën dhe problemet shoqërore
Java e nëntë	Naturalizmi, revolta e një gjenerate të re letrare; revolucionin letrar;
Java e dhjetë	Pozitivizmi dhe Naturalizmi, ndikimi i pozitivizmit
Java e njëmbëdhjetë	Mënyra e të shkruarit, pasqyrimi i letërsisë dhe artit në natyralizëm (Sekundenstil)
Java e dymbëdhjetë	Rrymat e kundërta të natyralizmit, shkrimtari dhe roli i artit, Deziluzioni dhe provokimi
Java e trembëdhjetë	Dekadencia, Simbolizmi dhe krijimtaria letrare; melankolia dhe estetizmi
Java e katërbëdhjetë	Impresionizmi dhe krijimtaria letrare; nervat dhe neuroza (Freud); moderna vjeneze ; Nietzsche dhe kulti i renesancës; arti për artin (l'art pour l'art).

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mësimi zhvillohet me ligjërata, ushtrime dhe me shpjegime përkatëse për rrjedhën historike dhe letrare të letërsisë së këtyre periudhave. Në fillim do të jepen informacione të përgjithshme në mënyrë kronologjike, si dhe rrjedhën e krijimtarisë letrare. Në vazhdimësi diskutohen shembuj nga krijimtaria e autorëve me në zë të kësaj periudhe, për gjinitë e ndryshme letrare si dhe komentohen temat dhe ngjarjet kryesore. Gjatë realizimit të këtij kursi, shfrytëzohet literaturë e pasur dhe zbatohet metoda ndërvepruese.

Përmes këtij kursi studentët pritet të thellojnë dijet përmes metodave dhe politikave të reja akademike, studentët duhet të vijnë me kohë në sallën e mësimi, atyre u kërkohet të jenë aktiv në pjesëmarrje, gjatë ligjëratave, në referime, diskutime, si dhe në punë seminarike.

MrN 27.02.25